



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.12.2019, ora 09:00

Drejtojnë mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nën për nën i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”
2. Të tjera

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Arben Kamani, Mirela Kumbaro, Ralf Gjoni, Klodiana Spahiu, Nikolin Staka, Edlira Hyseni, Kostaq Papa, Fatmir Velaj, Andrea Marto, Artemis Dralo, Arlind Çarçani dhe Ervis Meço.

Mungojnë:

Sadri Abazi

Të ftuar:

Etjen Xhafaj - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Ilda Degan - Drejtoreshe e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Daniela Cekani – Drejtoreshë e Fondeve të BE-së në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Altin Fuga – Përgjegjës Sektorit të Politikave Sektoriale në Drejtorinë e BE-së në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Mirëmëngjesi!

Kemi gati 35 minuta që presim zëvendësministrin, zotin Xhafaj. Unë isha gati ta anuloja mbledhjen, pasi është e papranueshme, zoti Xhafaj, që të vini në Komisionin e Integritetit 35 minuta me vonesë. Keni marrë njoftimin për orën 09:00, nuk më intereson fare nëse keni pasur mbledhje qeverie, çfarëdo që të keni pasur ne po diskutojmë buxhetin. Edhe ne kemi agjendat tona dhe jemi tejet të zënë në zonat tona dhe me gjërat që po ndodhin, dhe kemi pasur një seancë tepër të gjatë dhe kemi qëndruar në parlament e më pas në kryesi deri në orën 21:00. Kështu që është e papranueshme që ju të vini 35 minuta me vonesë. Po aq e papranueshme është fakti që ju nuk duhet të ishit fare këtu, por duhej të ishte ministri i Jashtëm në detyrë, i cili të vinte këtu dhe të prezantonte buxhetin, është e disata herë që ai e anulon takimin dhe sjell zëvendësministrin në Komisionin e Integritetit. Nëse ju keni vënë si prioritet integrimin e Shqipërisë në BE atëherë e shoh të papranueshme faktin që si ministri, ashtu dhe ju, vazhdoni ta denigroni këtë komision.

Gjithsesi këtë e merrni përsipër vetë dhe uroj të keni një arsye pse erdhët kaq vonë.

Fjalë është për zëvendësministrin, zotin Xhafaj, i cili do të bëjë shqyrtimin nën për nën të buxhetit të vitit 2020.

Etjen Xhafaj – Shumë faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, ju kërkoj ndjesë të gjithëve, por unë isha njoftuar për orën 10:00 dhe.

Rudina Hajdari – Kjo nuk është e vërtetë, zoti Xhafaj. Ju lutem shumë, sepse ka njoftim për në orën 09:00.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti zëvendësministër mund të flasë vetë.

E dëgjova këtë para se të vinte këtu dhe nuk keni pse të ngrini zërin, zonja Mesi, ai është në gjendje të shpjegojë vetë.

Senida Mesi – Unë dua ta dëgjoj pse ka ardhur me vonesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari - Atëherë kjo mbledhje anulohet.

Ralf Gjoni – Qetësohu!

Kryetarja anuloi mbledhjen dhe ne duhet të çohemi.

Senida Mesi – Kryetarja vendosi të ikë, nuk mund ta mbyllë mbledhjen kryetarja me te gjithë anëtarët e komisionit të pranishëm dhe me zëvendësministrin.

E keni totalisht gabim.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk e la të flasë zëvendësministrin.

Ralf Gjoni – Irenë e dashur, duhet të largoheni nga metodat provinciale të komunikimit, që vë re në komision.

Senida Mesi – Zoti Gjoni, mirupafshim dhe ditën e mirë!

Ju lutem, të kthehemi në zhvillimin e mbledhjes!

Zoti Zëvendësministër, vazhdojeni ku e latë!

Etjen Xhafaj – Faleminderit!

Unë dua ta përsëris edhe një herë që kërkoj shumë ndjesë për vonesën! Unë jam njoftuar për në orën 10:00 në komision dhe dje kam qenë deri në mesnatë në qarkun e Lezhës, si përgjegjës dhe i deleguar i Komitetit Ndërmintor për Menaxhimin e Emergjencave Civile dhe sot nga ora 07:00 kam qenë në mbledhje të qeverisë e në takime të tjera nga Shtabi, dhe në pamundësi për të pasur akses në telefon, derisa më gjetët.

Kërkoj ndjesë që u bëra arsye e kësaj vonese, por nuk ka absolutisht asnjë qëllim as nga unë e as nga institucioni që përfaqësoj, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, e cila është palë e interesuar në bashkëpunim me këtë komision, për të zhvilluar të gjitha politikat e integritit europian të Shqipërisë, sepse kjo nuk është vetëm prioriteti ynë si qeveri apo i këtij komisioni, por një prioritet dhe aspiratë e të gjithë qytetarëve.

Rrjedhimisht kërkoj ndjesë! Gjithashtu, ndjej nevojën për të sqaruar që Ministri në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme nuk është këtu për arsye objektive, duke qenë se sot zhvillohet Ministeriali i OSBE-së në Bratislavë. Rrjedhimisht duke qenë është vendi që merr presidencën e OSBE-së për vitin 2020, dhe besoj se këtë duhej ta dinte edhe kryetarja e këtij komisioni, është e pamundur që ai të mos jetë i pranishëm dhe do të jetë i pranishëm, si ai ashtu dhe Kryeministri dhe Ministri për Punët e Jashtme *de jure*, zoti Rama.

Duke ju kërkuar dhe një herë ndjesë, po vijoj me prezantimin e projektbuxhetit.

Senida Mesi – Zoti zëvendësministër, kishte dikush një kërkesë për procedurë.

Dakord.

Mund të vazhdoni me prezantimin, jo vetëm të prioritetëve, por dhe detajet e buxhetit, duke u fokusuar në vitin që vjen, duke marrë parasysh edhe prioritetet, qoftë për integrimin dhe hapjen e negociatave, qoftë për presidencën e radhës të OSBE-së!

Faleminderit!

Etjen Xhafaj – Faleminderit juve!

Ky është prezantimi i projektbuxhetit për vitin 2020 i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Buxheti i vitit 2020 është pjesë e planifikimit buxhetor afatmesëm të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për periudhën 2020-2022, pra për periudhën 3-vjeçare. Është hartuar në funksion të mbështetjes së aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ-së, duke përfshirë edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore. Planifikimi ka në themel të tij objektivat e përcaktuara në programin e qeverisë për politikën e jashtme, strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020, si dhe planin kombëtar të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të BE-së. Orientimi i politikës së jashtme për vitin 2020 do të jetë zgjerimi dhe intensifikimi i marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjikë, Europën dhe SHBA-të, por dhe vende të tjera të botës.

Gjithashtu, në fokus do të jetë thellimi i dialogut politik me institucionet europiane dhe avancimi i mëtejshëm në procesin e integritit europian me synim hapjen e negociatave për anëtarësim, përfaqësim aktiv dhe proaktiv në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale ku Shqipëria aderohet, në forumet shumëpalëshe dhe koalicionet ndërkombëtare ku ndajmë interesa dhe vlera të përbashkëta. Po kështu, prioritet do të ketë edhe përmirësimi i mëtejshëm i imazhit të vendit në botë, pasqyrimi i zhvillimit të reformave të gjithanshme në Europë, duke synuar tërheqjen e investimeve të huaja, përmirësimin e imazhit të Shqipërisë si një destinacion turistik dhe si *brand*, por dhe orientimi i tyre në sektorë strategjikë të zhvillimit të vendit tonë.

I fundit, por jo nga rëndësia, një objektivi tejet i rëndësishëm, mbetet sigurimi i një shërbimi cilësor, konsullor në funksion të mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Pra buxheti i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme operon me 4 programe buxhetore, planifikimi, menaxhimi dhe administrimi, mbështetja diplomatike jashtë shtetit, aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MEPJ-së dhe mbështetja institucionale për procesion e integritit.

Buxheti total i MEPJ-së për vitin 2020 është në vlerën e 3 miliardë e 636 milionë lekë. Rritja buxhetore për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 është në vlerën e 455 milionë lekësh. Kjo rritje buxhetore lidhet vetëm me mbulimin e kostove të aktiviteteve, të cilat do të organizohen në kuadër të kryesimit të OSBE-së për vitin 2020. Ndërkohë të gjitha synimet dhe objektivat e shërbimit të jashtëm, pavarësisht mosrritjes së tavaneve buxhetore në krahasim me vitin e kaluar, do të mbulohen falë një administrimi të mirë të burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore.

Projektbuxheti i vitit 2020 synon realizimin e objektivave kryesorë të aktiviteteve të ministrisë, që janë: integrimi europian, kryesimi me sukses i OSBE-së, kandidatura e

Shqipërisë për një vend të përkohshëm në Këshillin Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën 2022-2023, bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet me fqinjët dhe shqiptarët në rajon, diplomacia ekonomike, diaspora dhe shërbimi konsullor.

Më konkretisht, sipas secilës pikë: sa i përket integritit europian të vendit dhe komponentëve të tij kryesorë, buxheti që është planifikuar të akordohet për këtë vit do t'i shërbejë ministrisë për realizimin e prioritetëve siç janë hapja e negociatave të anëtarësimit me BE-në, garantimi i zbatimit të MSA-së mes Shqipërisë dhe BE-në, forcimi i kapaciteteve institucionale, në funksion të procesit të negociatave për anëtarësim. Për këtë qëllim po punohet për riorganizimin e strukturave të MEPJ-së për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të procesit të negociatave të anëtarësimit. Me miratimin e strukturës së re të ministrisë, miratuar së fundmi, do të ketë një përqendrim të kapaciteteve njerëzore përmes krijimit të një drejtorie të re të BE-së. Ky riorganizim do të sjellë një përdorim më efikas të burimeve njerëzore dhe do të krijojë premisa për një specializim më të mirë të specialistëve tanë sipas kapitujve negociues, do të forcojë koordinimin ndërinstitutional dhe metodologjik për të përballuar me sukses sfidat e procesit të negociatave të anëtarësimit.

Sa i përket asistencës financiare të BE-së, projektbuxheti i vitit 2020 do të mundësojë menaxhim më efikas të burimeve njerëzore të angazhuara në koordinimin dhe bashkërendimin e mbështetjes financiare të BE-së. Ky projektbuxhet mundëson ndarjen e Drejtorisë së Fondeve të BE-së në dy drejtori specifike, më konkretisht në Drejtorinë e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale IPA dhe Drejtorinë e Programeve të Bashkëpunimit Territorial. Kjo qasje do të fuqizojë kapacitetet e MEPJ-së në koordinimin më efikas të instrumenteve financiare të BE-së, sipas tipologjive të tyre, duke krijuar premisa më të mira për rritjen e kapaciteteve absorbuese të fondeve IPA. Kjo lëvizje bëhet edhe në kohën kur BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nisur një dialog dhe konsultim për hartimin e kuadrit strategjik të periudhës së re programore të fondeve IPA 2021-2027, e cila do të kërkojë një rol aktiv të strukturave tona dhe fuqizim të kapaciteteve. Theksojmë se MEPJ-ja është përcaktuar si koordinator kombëtar e fondeve IPA.

Lidhur me programin buxhetor 4, që është mbështetja institucionale për procesin e integritit, informojmë që shuma e planifikuar në zërin “investime” shërben për mbulimin e kostove lokale, pra TVSH-në dhe bashkëfinancim, për projektin e asistencës teknike, nga të cilat MEPJ-ja përfiton. Theksojmë se në këtë zë buxhetor për vitin 2020 ka një zvogëlim prej 95 mijë e 220 lekësh të reja, krahasuar me vitin 2019 në financimet e huaja. Arsyeja për këtë zvogëlim vjen për shkak të një projekti teknik, SME 4, *Capacity Building* për ministrinë.

Aktivitetet kryesore në kuadër të kryesimit të OSBE-së gjatë vitit 2020 pas marrjes së kryesisë së OSBE-së do të jenë në funksion të mbështetjes së rolit që Shqipëria duhet të luajë brenda kësaj organizate. Gjatë vitit 2019 janë alokuar kapacitete dhe fondet e nevojshme për ngritjen e *task force*-ës pranë MEPJ-së dhe të njësisë specifike pranë misionit në Vjenë. Me fondet e këtij buxheti u organizua me sukses në Tiranë edhe Konferenca Mesdhetare. Si kryesuese e radhës e OSBE-së Shqipëria duhet të organizojë një sërë aktiviteteve të rëndësishme gjatë vitit 2020 të cilat kanë kosto specifike financiare dhe janë planifikuar në buxhetin e këtij viti. Ndër to mund të përmendim mbajtjen e tri konferencave tematike në Tiranë, si ajo për antisemitizmin, terrorizmin, gjininë dhe rininë. Aktiviteti më i rëndësishëm i kryesisë shqiptare është takimi ndërministror, pra i ministrave të punëve të jashtme, i cili do të mbahet në 3-4 dhjetor 2020 në Tiranë dhe do të jetë si ai që po zhvillohet në Bratislavë sot dhe që do të mirëpresë 2000 delegatë dhe të ftuar të tjerë. Po kështu do të ketë edhe një sërë vizitash të kreut të MEPJ-së si kryetar i radhës në të gjitha zonat e konfliktit që mbulon OSBE/ODIHR-i nga 57 vende dhe në kryeqytete të tilla si Uashingtoni, Moska, Parisi apo Berlioni.

Gjithashtu do të ketë takime specifike në shtator 2020 në lidhje me dimensionin human, i cili mbahet çdo vit në Varshavë dhe në tetor 2020 për dimensionin ekonomik dhe mjedisor, i cili mbahet për vit në Pragë, në Çeki.

Duke ndaluar më tej te kandidatura e Shqipërisë për një vend të përkohshëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për periudhën 2022-2023, gjatë këtij viti do të vijojmë me komunikimin intensiv me vendet anëtare, sidomos me ato vende me të cilat Shqipëria nuk ka përfaqësi diplomatike të afërta. Në funksion të kësaj shkon edhe mbështetja që kemi me anë të buxhetit 2020 për zgjerimin e përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë, ku do të kemi një hapje të një ambasade në Addis Abeba me synimin e përhapjes së shërbimit të jashtëm edhe në kontinentin afrikan, për të pasur mundësi bashkëpunimi shumëpalësh dhe në kuadër të votave që duhen mbledhur në funksion të vendit në Këshillin e Sigurimit.

Këtu doja ta ndaloja pak para së të kalojmë te pyetjet. Sa i përket zgjerimit të përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë në botë dhe forcimit të kapaciteteve të shërbimit të jashtëm, parashikohet që në vitin 2020 të kemi hapjen dhe funksionimin e ambasadës në Kamberra të Australisë, si për ndërlidhjet, ashtu dhe për funksionet. Sigurisht vendimi ka kaluar, por këtë vit do të bëhet eficiente, do të kemi një mision të posaçëm në Kiev edhe në kuadër të presidencës së OSBE-së, ku na duhet të jemi të pranishëm në atë që është zona më e ngrohtë e konfliktit aktualisht. Do të kemi gjithashtu dhe 3 konsullata të përgjithshme në Ulqin, Preshevë dhe Manastir, të cilat do të shkojnë në funksionin e organizimit, dhe

angazhimit të diasporës, por edhe në përfshirjen dhe mirëpërfaqësimin e shqiptarëve në rajon dhe në trojet e tyre etnike.

Duke ju falënderuar dhe kërkuar edhe një herë ndjesë për vonesën time të paqëllimshme jam i hapur për pyetjet tuaja!

Senida Mesi – Falënderoj, zotin zëvendësministër!

Do ta doja t’ua kaloja fjalën kolegëve deputetë për komente dhe pyetje për buxhetin, sidomos për vitin që vjen.

Përpara se t’ua kaloja fjalën kolegëve do të doja të bëja një notë verbale me shkrim për faktin e vonesës. Unë e mirëkuptoj të gjithë situatën e krijuar, sidomos atë të pas tërmetit, ku i gjithë kabineti qeveritar, përfshi zëvendësministra, është i angazhuar jo vetëm me menaxhimin e emergjencës dhe postemergjencës, por duke pasur parasysh detyrimet e tjera ligjore, si në rastin konkret, edhe me pjesëmarrjen në evente shumë të rëndësishme, aq më tepër në një *event*, ku Shqipëria lloboi vitin e kaluar për të marrë presidencën e OSBE-së. Sot bashkë me Kryeministrin dhe ministrin në detyrë janë të pranishëm në dy institucione për të ndjekur dhe avancuar këtë agjendë shumë të rëndësishme.

Më vjen shumë keq për sjelljen e kolegëve të mi të opozitës, me të gjithë respektin që kam për zonjën Hajdari dhe zotin Gjoni, por nuk mund të vendosin një, apo dy individë zhvillimin apo jo të mbledhjes së sotme!

A ka pyetje dhe komente?

Të mbledhim të gjitha pyetjet, pastaj do t’ju jap fjalën për të komentuar.

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Nuk besoj se reagimi i mëparshëm është çështje e qëndrimit politik, apo opozitë, se ne jemi anëtarë të tjerë të opozitës parlamentare, por gjykojmë se secili, në disa raste vlerëson rrethanat, momentin dhe kushtet në të cilat ndodhet. Jam e bindur që vonesa juaj nuk është e qëllimshme për të mos i dhënë rëndësinë këtij komisioni, aq më tepër që situata e krijuar ka sjellë vonesa në avancimin e diskutimeve të buxhetit. Ne kemi qenë në një fazë, ku takimet dhe mbledhjet ishin të përditshme. Tërmeti krijoi një situatë të paparashikuar, ku të gjithë u gjendën të papërgatitur dhe kjo ka sjellë vonesa në ecjen e analizës me të. Prandaj ky komision, sikurse të gjitha komisionet e tjera që po merren me diskutimin e buxhetit, ka detyrën dhe përgjegjësinë të vazhdojë punën për arritjen e miratimit pas diskutimit të buxhetit në të gjithë elementet. Pavarësisht vonesës që mund të na ndodhe të gjithëve, se edhe ne, si anëtarë të komisionit, shpeshherë vonohemi, me apo pa të drejtë, duhet të mirëkuptojmë njëri-tjetrin dhe të jemi më tolerantë, prandaj qëndrimi im ishte vazhdimësia e kësaj mbledhjeje dhe nuk kam asnjë koment me zgjedhjet e secilit.

Në lidhje me buxhetin që po diskutojmë, situata e krijuar na ka shkaktuar një shkëputje nga analiza e zërave të buxhetit, pasi më përpara ishim më të mirinformuar. Unë mbaj mend që e kam diskutuar edhe në Komisionin e Ekonomisë se buxheti i 2020-s ka pasur lëvizje dhe ndryshime që nga viti 2019.

Sot ne diskutojmë buxhetin që i takon MEPJ-së, tani nuk e kam përpara tabelën që kisha përgatitur lidhur me vlerat krahasuese me vitin e kaluar, por mos qofsha e gabuar, ka një pakësim të buxhetit në disa zëra që ju përkasin. Një nga zërat që mbaj mend ishte mbështetja institucionale për procesin e integritetit, buxheti i të cilit është pakësuar në krahasim me vitin 2019.

A keni ju një opinion tuajin pse është pakësuar buxheti që lidhet me procesin e integritetit dhe mbështetjen që institucionet duhet t'i japin këtij procesi, porë kjo më syrin skeptik të qytetarit apo të deputetit? Mos ka të bëjë me faktin e pezullimit për momentin të avancimit të procesit, që pati një përgjigje negative në të kaluarën? A jeni dakord ju që është momenti që ne të forcojmë dhe të shtojmë buxhetet, që lidhen me proceset integruese, sepse Shqipëria mori një përgjigje negative, por ajo pret dhe ka nevojë për progres, pra për të ecur përpara? Pakësimi i buxhetit për këtë vit duket një paradoks, se ne presim që fondet të shtohen dhe të çdo institucion të mbështetet më fort në procesin e integritetit. Ndërkohë këtë vit buxheti parashikon një rënie të fondeve që lidhen me mbështetjen e procesit të integritetit.

E dyta, nuk e di nëse zëri i aktivitetit diplomatik dhe konsullor i MEPJ-së ka një rënie të buxhetit. A mendoni ju se ministria që përfaqësoni i ka të mjaftueshme buxhetet për të pasur një përfaqësim dinjitoz të Shqipërisë në lidhje me aktivitetin diplomatik dhe konsullor kudo që është?

Sot më shumë se kurrë ne kemi nevojë të ngremë zërin dhe të jemi dinjitozë kudo që përfaqësojmë vendin tonë, si për të treguar vlerat tona, ashtu dhe për të bindur njerëzit, partnerët apo fqinjët tanë që ne meritojmë më shumë se sa kemi arritur deri tani.

E fundit, në këtë situatë të krijuar nga tërmeti dhe pasojat e tij kuptohet që një vëmendje e madhe shkon te nevoja për të tërhequr apo bindur këdo që ka mundësi të japë donacione dhe ndihma. Partnerët tanë, fqinjët, të gjitha vendet përreth kanë treguar solidaritetin, ne i falënderojmë pa fund, por kemi ende nevojë për ta. Nuk dihet ende fatura financiare e dëmeve të tërmetit dhe ne ende presim të dimë se sa do jetë kontributi nga jashtë.

Mbase është shpejtë, por a keni krijuar një strategji, a keni një program tuajin si të nxisni, apo të kontribuoni që fqinjët partnerët, pra të gjithë miqtë tanë, të ndihmojnë me financime me donacione për të rindërtuar dhe për të kaluar pasojat e tërmetit?

Ju faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zonja Hyseni!

A ka kush pyetje?

Po, zoti Pendavinji.

Ilir Pendavinji – Faleminderit, zonja kryetare!

E dëgjova me vëmendje relatimin e zotit zëvendësministër për buxhetin dhe analizën që bëri këtu.

Kam një pyetje, zoti Xhafaj.

A jeni i kënaqur me këtë buxhet që po marrim në shqyrtim, duke pasur parasysh sfidat që ka Shqipëria vitin që vjen për integrimin, për kryesimin e OSBE-së? Ju thatë që nuk ka shtim të buxhetit që nga viti 2019.

Me të gjitha këto aktivitete që do të zhvillojë në kuadër të këtyre dy eventeve shumë të mëdha, si anëtarësimi, që besoj se vitin tjetër do të hapen negociatat, kryesimi i OSBE-së me konferenca, lobimet, udhëtimet jashtë të stafit tuaj për të ndjekur gjendjen në zonat e konfliktit, siç e relatuat, a do të donit rritje të buxhetit për hir të kësaj situatë të krijuar? Mbase nuk është momenti i duhur për të rritur buxhetin me fatkeqësinë që na ra, por besoj se ju duhet të kishit bërë një kërkesë për ndryshim me gjithë këto sfida të mëdha që keni përpara.

Faleminderit!

Senida Mesi – Zoti Papa.

Kostaq Papa – Faleminderit!

Në fakt, për problematikat që dolën pak më parë do të diskutoj pastaj, sepse doja të ndalesha te çështja e konsullatave. Ju thatë se do të vendosni konsullata të reja të përgjithshme në Ulqin, Manastir, Preshevë dhe kjo është gjë e mirë, por kam parasysh që shtetet e tjera, kur kanë të bëjnë me trojet, sepse Shqipëria kufizon me vetveten, i vendosin konsullatat në zona të rrezikuara të etnisë së tyre. Qyteti i Ulqinit ka 86% popullsi shqiptare, Manastiri është një qytet i rrezikuar, Presheva është me shumicë shqiptare, a nuk do të ishte më mirë që në Malin e Zi konsullata e përgjithshme të ishte vendosur në Tivar, se është afër me Ulqinin dhe me pjesën tjetër të territoreve shqiptare, me zonën e malësisë, me zonën e Podgoricës? Manastiri është një qytet ku shqiptarët kanë pasur një zhvendosje të detyruar prej shumë vitesh dhe në momente të caktuara kanë ndodhur ato netët e vështira ndaj shqiptarëve dhe përqindja e tyre ka rënë dukshëm. Kështu që e quaj të domosdoshme vendosjen edhe për efekt të krijimit të atij poli politik dhe diplomatik në Maqedoninë e Veriut.

Presheva, ka kompaktësi shqiptare, mbase mund të ishte vendosur konsullata në Metvegj. Kriza politike dhe problematikat në lidhje me shqiptarët sot janë në Metvegj, se atje

po bëhet një çregjistrim total i shqiptarëve, i cili do të pasojë me shpronësimin e tokave të tyre. Moseficiencia dhe mosprania ligjore, mungesa e kartave të identitetit dhe pa të gjithë prezantimin e tyre ligjor, do të thotë që edhe pse ata mund të jenë *de facto* në terren, do të kenë një mungesë të shërbimeve nga shteti që do t'i bëjë të largohen drejt trojeve të tjera shqiptare ose drejt diasporës.

Çështja tjetër lidhur me Preshevën, pra me vendosjen e konsullatës, është se këtij territori i duhen zbuluar dhe rikthyer vlerat shqiptare, si Sanxhaku. Janë me qindra e mijëra shqiptarë që identifikohen si të tjerë për efekt të krizës së identitetit që ka pasur në vitet e diktaturës komuniste. Pazari i Ri konsiderohet qendra e tyre. Aty sot ka një kthesë, ka një zgjim, por konsullata është ajo që ndikon.

Shtetet e huaja kanë vendosur konsullatat e tyre në qytete ku Shqipëri nuk ka penguar kurrë të drejtat e minoriteteve edhe pse kanë qenë të vogla. Minoriteti grek, që konsiderohet më i madhi në Shqipëri, nuk ka kurrë fuqinë dhe praninë politike sa e kanë shqiptarët e Malit të Zi. Megjithatë kemi pranuar dhe pranojmë, sepse deri tani shqiptarët janë populli më tolerant në Ballkan ndaj të tjerëve. Ndikimi i konsullatës duhet të zhdukë këtë deficiencë që ndodh në marrëdhënie, sidomos me shqiptarët. Duke qenë se Shqipëria kufizon me vetveten duhet patjetër ndikimi që të shmanget albanofobia nga popujt e tjerë, se ka qenë politike dhe ideologjike për zhvendosjen e trojeve të tyre. Në këtë suazë dua të di a do ta rishikoni më mirë vendosjen e këtyre konsullatave?

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Papa!

Edhe unë kam dy pyetje në lidhje me dy çështje shumë të rëndësishme.

Më 19 dhjetor të vitit 2018 kemi aprovuar me VKM vendimin nr. 749 strukturën e hapjes së negociatave, shprehimisht “Për krijimin dhe organizmin e funksionimit të strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave” dhe “Për krijimin dhe organizimin e funksionimit të strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në BE”.

Ne pritëm që në tetor të këtij viti të fillonte hapja e negociatave. Me shumë gjasat, dhe nga takimet që po zhvillojmë në kuadër të diplomacisë parlamentare, por edhe ju në kuadër të diplomacisë që po ndiqni, do të na hapen negociatat para takimit të Zagrebit që është në maj të vitit 2020. Të paktën lobimet po bëhen nga të gjitha vendet mbështetëse dhe anëtare për një qasje të tillë.

Kemi para një udhërrëfyes, rezolutën e aprovuar nga Bundestagu gjerman, i cili parashikon në detaje hapa të cilat, në momentin që ne do të realizojmë brenda afateve, sikurse

është Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, dakordësimi dhe arritja e një konsensusi dhe aprovimi në parlament, reforma zgjedhore në bazë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it etj, ne t'i kemi të gjitha parakushtet e plotësuara, me qëllim që vendet anëtare të BE-së të ulen edhe një herë në tryezë për të akorduar hapjen e negociatave për bisedim për anëtarësimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Si rrjedhojë, automatikisht, vendimi, që i referohem, hyn në fuqi. Nuk e di nëse buxheti i vitit që vjen parashikon në detaje strukturën e re dhe buxhetin për të paguar strukturën e re.

Elementi i dytë është presidenca e OSBE-së. Nga informacioni që kam duhen rreth 10 milionë euro financime për zhvillimin e takimeve në Vjenë, ashtu dhe takimet ministeriale e konferenca brenda Shqipërisë.

A e kemi sot që flasim të akorduar një shumë të tillë? Nëse jo, si është menduar të ndahet? Me transhe apo me pjesë, me qëllim që ne, jo vetëm ta përfaqësojmë Shqipërinë si duhet, por edhe të jemi një linjë me të gjitha standardet e përcaktuara. Ashtu sikurse vendet e tjera kanë mbajtur standarde të larta përfaqësimi të një strukture të tillë, ta mbajmë edhe ne.

Në lidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm e di që ministria juaj nuk është e vetmja ministri përgjegjëse për agjendën 2030. Për agjendën 2030-a është Këshilli i Ministrave që koordinon të gjitha çështjet dhe punën në lidhje me realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Vitin që vjen duhet të aprovohet strategjia e re për zhvillim dhe integrim dhe nuk e di ku jemi me të, prandaj kërkoj të mbahet shënim në mbledhjen e këtij komisioni, por do ta kërkoj edhe në grupin parlamentar dhe në kabinet. Një strategji e tillë, kaq e rëndësishme e Shqipërisë, e cila përfshin të gjithë sektorët dhe ministrinë, jo vetëm zhvillimin, por edhe integrimin, duhet të kalojë në Kuvend për miratim, të kalojë në komisionet përkatëse, Komisionin për Politikën e Jashtme e kështu me radhë, pasi e gjykoj që është një nga strategjitë më të rëndësishme, më gjithëpërfshirëse. Me aprovimin e asaj strategjie janë të gjitha strategjitë e tjera sektoriale, që lidhen me këtë strategji. Në këtë qasje do të doja që edhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme të ketë një komponent po aq të rëndësishëm të agjendës 2030 për realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, që kërkon një sintetizim të buxhetit të ministrive përkatëse për të parë nëse jemi në linjë me atë që kemi sot apo nesër të aprovuar në strategji.

Ju faleminderit!

Etjen Xhafaj – Mundem?

Faleminderit të gjithëve për pyetjet, që besoj se janë shumë të vlefshme në kuadër të asaj që duhet të shpjegojmë, si dhe të shtjellimit me detaje jo vetëm të shumave, por dhe të aktiviteteve, që vijnë pas shumave që parashikohen brenda buxhetit 2020!

Për sa i përket pyetjes së parë, për pakësimin e buxhetit në lidhje me BE-në, doja të sqaroja një fakt. Ministria në të gjitha projektet ku bën pjesë, mbulon vetëm pjesën e kostove lokale, që do të thotë 15-përqindëshin e TVSH-së dhe pastaj kostot që janë shumë të vogla. Arsyeja pse në terma finalë dhe shifrorë, pra në terma absolutë, kemi një ulje të shumës këtu, është se kemi mbylljen e një projekti të asistencës teknike, i cili është projekti SMEI 4, pra *capacity building*, që kishte të bënte drejtpërdrejt me rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve brenda Ministrisë për Integrimin European, tanimë Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, për përgatitjen e procesit të negociatave dhe aproksimimin, siç quhet, të procesit të përfarimit ligjor. Pra, kjo është diçka që ka lidhje të drejtpërdrejtë me një projekt specifik dhe nuk paraqet në asnjë mënyrë qasjen e përgjithshme buxhetore.

Gjithashtu, ka disa pakësime në funksionet specifike, duke qenë se tanimë prej 2 vjetësh e gjithë Shqipëria, rrjedhimisht edhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, është përfshirë tërësisht në një proces derregullimi, pra në një proces reduktimi dhe thjeshtëzimi të të gjitha procedurave për të mundësuar një qasje më të afërt dhe më të shpejtë për të gjithë qytetarët. Për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme ka një numër të madh shërbimesh, që kanë kaluar dhe tanimë zhvillohen *online*, rrjedhimisht edhe për atë ka një shkurtim të buxhetit, duke qenë se ka një kursim brenda këtyre shërbimeve, sepse tani nuk ka nevojë të ketë përfaqësues që t'i administrojnë.

Për atë që ju thatë si pikë të fundit, për mbështetjen diplomatike jashtë vendit, zëri specifik, i cili është reduktuar, është ai i investimeve, duke qenë se nuk ka më aq shumë nevojë për rindërtime, konstruksione apo pajisje në ambasada. Mendoj se kjo është një gjë e vlefshme, sidomos duke konsideruar edhe situatën lokale dhe vendimin e qeverisë për t'i eliminuar të gjitha këto shpenzimeve gjatë këtij viti, që është një vit emergjence për sa i përket rindërtimit.

Do të doja të kombinoja pyetjen që bëri deputetja Mesi me pyetjen e deputetit Pendavinji për sa i përket financimit të OSBE-së dhe buxhetit në përgjithësi. Shqipëria është një ndër vendet që shpenzon më pak për sa i përket shërbimit të jashtëm. Megjithatë, kjo nuk limiton një asnjë mënyrë qoftë cilësinë e funksioneve të shërbimit të jashtëm, qoftë atë që ka qenë dhe ka ardhur gjithmonë në vazhdimësi: përmirësimin e performancës brenda shërbimit të jashtëm. Besoj se një provë dhe testament i kësaj është edhe fakti që kemi marrë dy konfirmime pozitive nga Komisioni European. Ne do të kishim dëshirë që rritja të ishte

shumë e madhe, megjithëse specifikisht ka rritje, por si të gjitha institucionet e tjera publike në Shqipëri përpiqemi të bëjmë më të mirën, duke konsideruar kushtet dhe besoj se deri tani ka pasur një histori suksesi.

Doja të theksoja se nuk ka një reduktim të buxhetit të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Përkundrazi, ka një rritje, që në vlera absolute është 455 milionë e 880 mijë lekë të rinj, që do të shkojnë kryesisht në drejtim të presidencës së OSBE-së. Financimi i OSBE-së bëhet në bazë të kalendarit të aktiviteteve dhe të ndarjes ciklike të tyre. Është ende në negociim pjesa tjetër.

Për sa i përket parashikimit të shpenzimeve që do të ketë çdo vend, kjo është diçka që vendoset nga çdo qeveri dhe nga çdo vend që merr presidencën. Ka raste kur është marrë edhe më pak se shuma për të cilën jemi angazhuar, por ka raste kur është shkuar përtej.

Në bashkëpunim me sekretariatit e OSBE-së dhe me të gjitha vendet, që kanë sekonduar, le të themi, ekipet shqiptare që po përgatisin (që nga taskforca e deri te misioni ynë në Vjenë) këtë fazë tranzitore për të marrë presidencën, është rënë dakord që shuma optimale, duke parashikuar të gjitha aktivitetet, do të ishte ajo që tha deputetja Mesi, që është edhe objektivi ynë. Për 6 muajt e parë ne kemi buxhetuar gjysmën e shumës për të gjitha aktivitetet e mëdha dhe në vijim të kësaj do të buxhetohet për aktivitetin specifik, që është minsiteriali, i cili zhvillohet në javën e parë të dhjetorit. Rrjedhimisht, ka një kohë për t'u përgatitur, siç është ajo që po zhvillohet sot në Bratislavë. Do të ketë një rishikim të buxhetit dhe një kërkesë. Të jeni të sigurt që angazhimi është marrë nga qeveria me 56 vendet e tjera anëtare të OSBE-së dhe do të vijojë të qëndrojë.

Pjesa e dytë e buxhetit të OSBE-së ka të bëjë specifikisht me një aktivitet, që është aktiviteti i përmbylljes së presidencës, i cili do të jetë në dhjetor të vitit që vjen.

Për t'u kthyer te pjesa e vendosjes së konsullatave, këto të fundit tipikisht nuk vendosen në vende ku ka probleme specifike, por në vende ku ka nevojë për shërbime shtesë, sepse ka popullsi me numër të madh shqiptarësh. Përgjithësisht konsullatat kanë një funksion më të limituar politik për sa i përket funksionalitetit të tyre, por kanë edhe një funksion që rrotullohet rreth shërbimeve që ato ofrojnë për qytetarët e vendit që i inicion. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse është vendosur të kemi një përfaqësi në këto tri komunitete shqiptare, të cilat janë komunitete vibrante dhe në një proces zhvillimi të vazhdueshëm.

Aktualisht, Shqipëria nuk ka probleme specifike me asnjë nga fqinjët, qoftë në nivel dypalësh, qoftë në nivel rajonal, për sa i përket një rreziku për komunitetet shqiptare. Përkundrazi, ne i shikojmë konsullatat që po hapen si një mjet fuqizimi të këtyre pakicave shqiptare, pavarësisht se këto janë në trojet e tyre etnike, absolutisht, dhe synojmë që

nëpërmjet konsullatave t'u gjendemi më afër, t'u ofrojmë më shumë shërbime, por, nga ana tjetër, të kemi edhe një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi, për të parë mundësi të tjera bashkëpunimi dhe zhvillimi të këtij bashkëpunimi.

Për sa i përket ruajtjes së vlerave shqiptare dhe zhvillimit të këtij bashkëpunimi edhe më tej, doja të theksoja se që nga viti 2017 është ministri i Shtetit për Diasporën dhe janë tri agjenci, të cilat merren specifikisht me funksionet e këtij bashkëpunimi, siç është Agjencia Kombëtare për Diasporën, fondi dhe qendra e publikimeve. Pra, ka një kuadër bashkëpunimi, që është më i gjerë se..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, Dhoma e Tregtisë.

Ka një kuadër bashkëpunimi me diasporën, por edhe me shqiptarët në trojet etnike, që është goxha më i gjerë se oficerët apo zyrtarët konsullorë. Besoj se pavarësisht kësaj do të kemi një përmirësim tjetër të mëtejshëm cilësor gjatë vitit në vijim, të mbështetur edhe nga buxheti që diskutojmë sot.

Për sa i përket strukturës shtetërore për emërimin e kryenegociatorit dhe negociatorëve, që ishte edhe pyetja e deputetes Mesi, pas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.749, datë 19.12.2018... Është e vërtetë që ky është vendimi i Këshillit të Ministrave për emërimin e kryenegociatorit dhe negociatorëve dhe ka të bëjë me pjesën tërësisht teknike të procesit. Duke parë që të paktën 18 muajt e fundit, veçanërisht 12 muajt e fundit ka pasur gjithmonë e më shumë një relevancë politike të të gjithë këtij procesi dhe për Shqipërinë pavarësisht se është diskutuar në shumë nivele dhe shumë nga kapitujt vazhdojnë të raportohen në mënyrë të rregullt, deri në javën e parë të janarit duhet të ketë pasur për të gjithë kapitujt të paktën një takim rakordomi me komisionin dhe institucionet e tjera të Bashkimit Europian. Ky proces në tërësinë e tij ka qenë politik deri tani.

Ristrukturimi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme shkon pikërisht në funksion të kësaj, nga njëra anë, duke specializuar edhe më tej teknokratët e ministrisë, të cilët merren me procese specifike, madje edhe me raportimin për kapituj specifikë dhe, nga ana tjetër, na mundëson një riadaptim të institucioneve apo të drejtorive dhe strukturave brenda Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, qoftë në kuadër të negociatave që bëhen për marrëveshjet për fondet IPA, qoftë edhe për ndjekjen dhe vijueshmërinë e negociatave.

Për sa i përket pyetjes për agjendën 20-30, strategjia e re për zhvillim është një atribut i Këshillit të Ministrave, të cilin Ministria për Europën dhe Punët e jashtme e monitoron dhe është pjesë aktive e të gjitha proceseve. Në qoftë se do të ndodhte lidhja strukturore, që u sugjerua nga ju, me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, do të duhet të kishte një

reflektim specifik në buxhet, por duke qenë se ky nuk është kushti tani dhe kjo ka qenë, deri në momentin kur flasim, një punë *business as usual* e ministrisë, ku ka pasur drejtori specifike dhe persona specifikë, që i ndjekin këto procese dhe kontribuojnë në të gjitha komisionet dhe komitetet respektive, nuk ka asnjë kusht për të cilin do të duhej të ndryshohej buxheti për t'u adaptuar në këtë drejtim.

Faleminderit!

Senida Mesi – Të falënderoj, zoti Xhafaj!

Me lejen e kolegëve anëtarë të Komsionit për Integrimin European, do të doja që struktura e re e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, që u referua këtu, të na prezantohej edhe në Komisionin e Integritit European, për të parë dhe për të suportuar edhe ne, jo vetëm për vendimet përkatëse për integrimin, por për të parë nëse struktura e re përngjason ose përshtatet me të gjitha nevojat që do të ketë Shqipëria vitin që vjen.

Për sa kohë jemi duke trajtuar nen për nen edhe buxhetin për 2020-n (një pjesë prej nesh janë njëkohësisht edhe anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave), do t'ju lutesha, nëse keni ndonjë kërkesë specifike për ndryshimin e disa zërave të buxhetit, për sa kohë jemi në trajtimin nen për nen edhe te Komisioni për Ekonominë dhe Financat, me shkresën përcjellëse të strukturës së re dhe ku synon kjo strukturë, të na përcillni (nëse keni) edhe kërkesat nga drejtoria përkatëse e buxhetit dhe e financave për ndryshimin e zërave, për t'i trajtuar, për t'i përcjellë dhe për të marrë vendim në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave. Nëse dikush ka ndonjë pyetje apo koment...

Po, zoti Papa, bëni një koment.

Kostaq Papa - E thashë edhe pak më parë, duhet të zgjidhen shpejt dhe mirë problematikat që ka komunikimi midis Komsionit të Integritit dhe Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Ajo që ndodhi në fillimet e komisionit tonë, nuk duhet të ndodhë më. Njëkohësisht, ne si deputetë mbajmë qëndrime politike për veprimet teknike që ndodhin, për vonesat e të tjera, por më tepër veprimet duhet t'i bëjë administrata e komisionit me njoftime, që të mos kemi konsekuenca të tilla.

Do të doja të ndalesha pak te problematika e zërave të fondeve të buxhetit, që duken të zvogëluara, në një kohë kur jemi në periudhën zenit të përpjekjeve për realizimit të synimit tonë për integrimin. Praktikisht, kjo tregon se ndikon dhe rezultati është se vonesa, që nuk morëm datën e nisjes së fillimit të negociatave, ka çuar... Siç tha edhe nënkryetarja, duhet të kërkonim në pika të caktuara për të bërë ndikimin direkt, për të pasur lobime të shpejta në kohë të shkurtër dhe në takime të caktuara, që të realizohen në fillim të vitit 2020, duke ditur që Bashkimi European ka thirrur një mbledhje më 11 dhjetor, që do të ketë lidhje me Shqipërinë.

Do të doja të na shpjegonit diçka, në qoftë se keni diçka më tepër. Më 11 dhjetor, prej 15 ditësh, është kërkuar thirrja e një mbledhjeje me institucionet e Bashkimit European, që do të ketë synimin të prekë problemin e asaj që ndodhi me Shqipërinë për mosfillimin e negociatave.

Problemi tjetër që desha të trajtoja ka të bëjë përsëri me konsullatat. Paralel me veprimin që bëni për realizimin e ngritjes së këtyre konsullatave, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme duhet të përqendrojë vëmendjen (unë jam përfaqësues tipik i problematikave të krahinave Preshevë-Bujanovc-Medvegjë) te problematikat e çregjistrimit të rreth 4500 qytetarëve dhe te problematikat e tjera që po ndodhin sot aty. Është bërë me dije se nuk kemi reagim as nga politika e jashtme shqiptare e Tiranës, as nga ajo e Prishtinës, ndërkohë që ndodh kjo gjë. Kështu që, nëse ju keni reagimet dhe kanalet tuaja të brendshme, qytetarët kanë nevojë të shohin kanale të hapura të reagimit, përveç reagimit diplomatik Faleminderit!

Senida Mesi – Po, zoti Xhafaj.

Etjen Xhafaj - Faleminderit për pyetjet!

Po e filloj nga pyetja e fundit. Siç mund të jeni në dijeni, jo më larg se 2 javë më parë përfaqësuesit në nivel politik nga të gjitha anët e spektrit të Luginës së Preshevës, Bujanovcit dhe Medvedgjës, kanë qenë në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme për të diskutuar specifikisht qoftë problematikat, qoftë një qasje të përbashkët të tyre për t'u përballur me sfidat aktuale të komuniteteve shqiptare që jetojnë në të tria zonat, por edhe për sfidat e tyre zhvillimore duke parë para.

6 muajt e fundit ne kemi pasur kontakte dhe komunikime konstante me përfaqësues nga të gjitha anët e spektrit politik të rajonit. Ka pasur një projekt specifik në Preshevë, i cili ka mbështetje buxhetore me fonde nga qeveria shqiptare dhe jemi në një dialog të vazhdueshëm me qytetarët e Luginës së Preshevës për të diskutuar të gjitha problematikat e tyre. Sigurisht, kjo është edhe një arsye më tepër pse konsullatat po vendosen në Preshevë, për të pasur një mundësi për të qenë më afër tyre, qoftë në nivel të shërbimeve, qoftë në nivel të shqetësimeve dhe të nevojave që ata kanë.

Për sa u përket zërave të përgjithshëm buxhetorë, në lidhje me prioritetet e politikës së jashtme, më besoni, është vërtet ashtu siç thoni ju, zoti Papa. Ne jemi në zenitin e qasjes sonë me Bashkimin European, por kjo nuk është një pikë unike. Ne kemi 3 vjet që jemi në këtë pikë zeniti, ku jemi duke negociuar në mënyrë shumë intensive si me komisionin, me institucionet specifike të Bashkimit European, ashtu edhe me 28 vendet anëtare, që do të behën 27, për prioritetet tona dhe për prioritetin madhor për hapjen e negociatave sa më

shpejt të jetë e mundur. Rrjedhimisht, angazhimi i buxhetit është bërë dhe ky do të jetë buxheti i tretë që i parashikon të gjitha këto aktivitete. Në asnjë moment nuk ka pasur nga asnjë burim, asnjë shenjë që problemet apo vendimi që nuk u mor kishte lidhje të drejtpërdrejtë me fondet e alokuara për çfarëdo qasjeje apo veprimi teknik nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, sepse ky është një prioritet kombëtar për të gjithë ne. Absolutisht, ne e kuptojmë qoftë përgjegjësinë, qoftë interesin e të gjithë shqiptarëve dhe besoj se në këtë drejtim do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me të gjitha institucionet.

Takimi i datës 11...

Vazhdojnë të bëhen takime teknike për të diskutuar modalitetin e rishikimit të formatit të zgjerimit të Bashkimit European. Takimi nuk është specifik për Shqipërinë dhe nuk ka pasur një vendim specifik për Shqipërinë, duke qenë se përplasja ka qenë e dyanshme. Kjo nuk do të thotë që ne nuk po i vazhdojmë takimet, diskutimet apo sqarimet në çdo nivel me ato vende apo institucione specifike të vendeve anëtare, të cilat kanë ende pikëpyetje për fusha specifike, sektorë specifikë apo edhe legjislacion specifik.

Kështu që besoj se në këtë drejtim jemi në krye të punëve dhe do ta vazhdojmë edhe më tepër këtë angazhim vitin që vjen.

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Megenëse nuk ka pyetje të tjera ose diskutime...

Keni pyetje? Hapësira për pyetje mbaroi. Nëse është një koment, bëjeni.

Edlira Hyseni – E fundit, për të përmbledhur atë që u tha, unë nuk e kuptova, ju përfundimisht jeni dakord me këtë buxhet, apo aktualisht keni (se u bë kohë që e keni buxhetin në tavolinë) formuluar tashmë një kërkesë, një ide se çfarë do të kërkonit?

Unë jam pjesë e Komisionit të Ekonomisë, bashkë me kolegë të tjerë.

Ju e keni tashmë një ide, por për çfarë konkretisht kërkonit rritje, apo pakësim (ndoshta nuk keni nevojë për fonde) të këtij buxheti, që aktualisht është parashikuar, duke pasur në konsideratë që buxheti do të rishikohet në tërësinë e tij? A keni, tashmë, konkretisht shifra dhe zëra konkretë që doni t'i rrisni, apo t'i ulni? Faleminderit!

Etjen Xhafaj – Keni shumë të drejtë, pasi këtë pjesë të pyetjeve nuk e adresova më përpara. Është kërkuar, në fakt, një ndryshim i zërave dhe është paraqitur pranë Komisionit për Politikën e Jashtme. Ndryshimi ka të bëjë specifikisht me pyetjen e deputetes Mesi, pra me alokimin e plotë të buxhetit për presidencën e OSBE-ODIHR-it. Kjo gjë është paraqitur në Komisionin për Politikën e Jashtme, mund ta sjellim edhe këtu. Absolutisht do ta sjellim edhe strukturën e rishikuar, e cila tani është duke kaluar edhe në komisionet parlamentare.

Senida Mesi – Duke ju falënderuar, zoti Xhafaj, për rezymenë, ne jemi të gatshëm dhe presim çdo kërkesë, për sa kohë kemi edhe dy javë trajtimin nën për nën të buxhetit dhe të ndryshimeve përkatëse për vitin 2020. Do të doja të bëja një falënderim në fund, besoj se do të donit edhe ju, në lidhje me koordinimin dhe punën e mrekullueshme që ambasadorët tanë, në bashkëpunim edhe me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, kanë bërë, nga njëra anë, duke sensibilizuar dhe, nga ana tjetër, duke menaxhuar të gjithë ndihmën e huaj, si rezultat i ngjarjeve të tërmetit që nga mëngjesi i 27 nëntorit dhe në vazhdim, duke sjellë jo vetëm ndihma, por edhe individë, specialistë, skuadrat e kërkim-shpëtimit dhe çdo ndihmë të mundshme që kanë pasur apo çdo kërkesë nga Komiteti i Emergjencave apo nga ministritë përkatëse në lidhje me zonat e prekura.

Për këtë dua t'ju falënderoj jo vetëm ju, por edhe punën e ambasadorëve, duke filluar me Rumaninë, Italinë, Greqinë, Bullgarinë, Gjermaninë, Francën, Kroacinë, ambasadorët tanë që kanë koordinuar së bashku me ju dhe vazhdojnë ende sot, ndihmën e huaj!

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Etjen Xhafaj – Faleminderit edhe ju!

Senida Mesi – Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të kalojmë në votim?

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nën për nën nuk kemi ndryshime apo propozime, kështu që parimisht jemi dakord.

Nëse do të na sillni diçka me shkrim apo anëtarë të caktuar të Komitetit mund të bëjnë kërkesë te Komisioni për Ekonominë dhe Financat, do t'i trajtojmë aty ndryshimet e mundshme.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA